

## Shtojca II – Fazat dhe metodologjia e vrojtimit

AMF në bashkëpunim me INSTAT ndërmorën këtë aktivitet statistikor në nivel vendi. Procesi i vrojtimit, metodologjia e përdorur për kryerjen e vrojtimit, si dhe përpunimi i informacionit janë përgatitur nga Elsa Dhuli dhe grupi i specialistëve të INSTAT. Gjatë këtij procesi është punuar ngushtësisht me grupin e specialistëve të AMF-së.

### II.1. Fazat e procesit të vrojtimit

Procesi i vrojtimit kaloi në tri faza, të cilat shtjellohen në vijim:

1. **Faza përgatitore.** Gjatë kësaj faze u kryen të gjitha aktivitetet e nevojshme për të mbështetur vrojtimin në terren. Fillimisht u përcaktua se njësia bazë e vrojtimit do të ishte ndërmarrja dhe vrojtimi do të orientohej drejt njohjes së njohurive dhe qëndrimeve mbi planet e pensionit profesionale dhe personale. Mbi këtë bazë hartua, diskutua dhe u përgatit formati përfundimtar i pyetësorit që do të përdorej në vrojtim. Më pas u përcaktuan kriteret për përzgjedhjen e ndërmarrjeve për t'u vrojtuar dhe u ndërtua kampioni përfaqësues. Gjithashtu, u përcaktuan metodat dhe mjetet që do të përdreshin gjatë vrojtimit me synimin për të rritur shpejtësinë e grumbullimit të informacionit dhe saktësisë së tij. U vijua me angazhimin dhe trajnimin e grupit të anketuesve dhe ndërtimin e programit për vrojtimin.
2. **Faza e vrojtimit në terren.** Gjatë kësaj faze fillimisht u bë një testim pjesor i pyetësorit për të përmirësuar më tej përmbajtjen e pyetësorit dhe mënyrën e kryerjes së anketimit (shih metodologjinë e studimit). Më pas u kalua në vrojtimin në terren nga i gjithë grupi i angazhuar i anketuesve të INSTAT.
3. **Faza përmbyllëse.** Gjatë kësaj faze u vijua me grumbullimin, kontrollin pastrimin, përpunimin, analizimin e informacionit, diskutimin me grupin e specialistëve të AMF-së dhe prodhimin e raportit përfundimtar.

### II.2. Metodologjia e studimit

#### II.2.1. Kampionimi

Për zgjedhjen e kampionit u përdor Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve të vitit 2014. “Grupi i targetuar i popullatës në studim” u krijua duke respektuar kriteret e përcaktuara paraprakisht ku përfshihen:

- Ndërmarrjet me 20 të punësuar e lart;
- Aktiviteti Ekonomik sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 në nivel seksioni nga A në S, përjashtuar seksionin O;
- Ndërmarrjet me pronësi private jobujqësore.

Në këtë mënyrë u krijua *Frame* me 2130 ndërmarrje, prej nga u përzgjedh kampioni me madhësi 651 ndërmarrje. Metoda e zgjedhjes është *Stratified Systematic Random Sampling (SSRS)*, ku si variabla stratifikimi shërbyen aktiviteti ekonomik i ndërmarrjes dhe madhësia e ndërmarrjes sipas numrit të të punësuarve.

Shpërndarja e kampionit nëpër strata është kryer sipas metodës *NEYMAN Allocation*, bazuar në numër të punësuarish. Kjo metodë krijon mundësinë për përgjithësimin e rezultatit për të gjithë

grupin e targetuar të ndërmarrjeve, me një precizion saktësie të vlerësimit të numrit gjithsej të të punësuarve prej rreth 98 përqind, pra me një marzh gabimi rreth 2 përqind.

**Tabela 4: Shpërndarja e kampionit të ndërmarrjeve sipas qarkut**

Qarku	Nr i ndërmarrjeve të anketuara	Nr i ndërmarrjeve të përgjigjura	Refuzime / Pa kontakt	Të mbyllur / Të fjetur
<b>Gjithsej</b>	651	535	97	19
Berat	11	9	1	1
Dibër	12	10	1	1
Durrës	75	66	3	6
Elbasan	16	15	1	0
Fier	39	38	0	1
Gjirokastrë	8	7	1	0
Korçë	12	12	0	0
Kukës	2	2	0	0
Lezhë	9	9	0	0
Shkodër	29	29	0	0
Tiranë	422	323	89	10
Vlorë	16	15	1	0

Analiza e vrojtimit i referohet numrit të ndërmarrjeve të përgjigjura, të cilat kompensojnë mospërgjigjet (refuzimet / pa kontakt) dhe estimojnë 2074 ndërmarrje. 19 ndërmarrje që janë jashtë qëllimit të vrojtimit (të mbyllur / të fjetur) estimojnë 56 ndërmarrje (shih raportin teknik më poshtë).

### **II.2.2. Pyetësi**

Pyetësi përmban pyetje të përgjithshme për ndërmarrjen, pyetje mbi ndërmarrjet të cilat aktualisht nuk kanë plan për krijimin e një fondi për pension profesional privat, si dhe mbi ndërmarrjet, të cilat kanë në plan krijimin e një fondi për pension profesional privat (shih shtojca 1).

Pyetësi u hartua në format letër dhe u zhvillua si aplikacion në tablet. Përdorimi i tableteve eliminon procesin e veçantë të hedhjes së të dhënave kompjuterike në sistem, duke ulur kohën e hedhjes së të dhënave me operator. Për krijimin e aplikacionit në tablet u përdor programi *CSPRO 6.0*. Kushtet logjike dhe kushtet e rrugëzimit në pyetësor u vendosën në aplikacion. U krijuan skedarët e nevojshëm për transmetimin e të dhënave duke përdorur lidhjen *FTP* me serverat e *INSTAT*. Transmetimi i të dhënave nëpërmjet këtij sistemi mundësoi zvogëlimin e kohës që u duhen të dhënave të vijnë nga terreni në zyrën qendrore. Për ta bërë trasmetimin e të dhënave sa më të sigurt midis tableteve dhe serverit ku ruhen të dhënat në *INSTAT* u krijuan një rrjet *VPN*-je. Tableti u testua disa herë për të parë ecurinë e programit dhe testuar kushtet e rrugëzimit. Konfigurimet e nevojshme u kryen në të gjithë tabletët për vendosjen e aplikacionit ku ishte pyetësi i dixhitalizuar dhe për trasmetimin e të dhënave.

### **II.2.3. Metoda e grumbullimit**

Intervistat me ndërmarrjen u kryhen nëpërmjet dy metodave: *PAPI* (Intervistimi me pyetësor letër me anketues) dhe me metodën *CAPI* (Intervistim i drejtpërdrejtë i asistuar nga kompjuteri). Nëpërmjet metodës *CAPI*, anketuesi kreu intervistën duke përdorur tabletët në të cilat ishte i vendosur pyetësi i dixhitalizuar. Pyetësi i dixhitalizuar ka të integruara kushte logjike për çdo pyetje individuale dhe për pyetje të lidhura në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën. Kjo ishte e rëndësishme për të siguruar një cilësi të mirë të rezultateve të vrojtimit. Për rrethet e vogla me një

numër të kufizuar ndërmarrjesh u përdorën pyetëtori në letër. Anketuesi kishte udhëzuesin në të cilin ishte shpjeguar përmbajtja e çdo pyetjeje, mënyra e përdorimit të tabletit, si dhe mënyra e hedhjes dhe regjistrimit të të dhënave në tablet. Gjithashtu, udhëzuesi përmbante rregulla për mënyrën dhe shpeshhtësinë e paraqitjes së anketuesit tek ndërmarrja. Në çdo tablet ishte vendosur një manual për përdorimin e tabletit (për anketuesit të cilët nuk janë familjarë me përdorimin e pajisjes) dhe manuali më i detajuar për përdorimin e aplikacionit ku ishte i vendosur pyetëtori dhe shpjegohej me figura hap pas hapi hedhja e pyetësorëve në tablet dhe hapat që duhet të ndiqeshin për transmetimin e të dhënave në INSTAT.

Pyetëtori fillimisht i adresohet për plotësim menaxherëve dhe administratorëve. Në mungesë dhe me autorizim të tyre u kalua në nivelet e tjera të hierarkisë si: burime njerëzore, financiere ose persona të tjerë të autorizuar nga personat e mësipërm. Kjo hierarki e synuar e adresimit të pyetësorit rezultoi si më e përshtatshme nga procesi i testimit paraprak.

Pas përfundimit të punës në terren anketuesit e rretheve të vogla dorëzuan pyetësorët në INSTAT, ndërsa të tjerët bënë transmetimin e të dhënave. Të dhënat u bashkuan dhe transferuan në skedarë të dhënash të projektuar për këtë qëllim. Për përpunimin e të dhënave u përdor instrumenti SPSS.

#### ***II.2.4. Kapacitetet***

INSTAT angazhoi persona, të cilët mbuluan punën e terrenit sipas procedurave standarde. Numri i tyre u përcaktua sipas madhësisë së kampionit dhe shpërndarjes gjeografike të ndërmarrjeve për çdo qark. Kategoria e personave që u angazhuan me punën në terren:

- a. Anketues;
- b. Kontrollor.

Përpara fillimit të vrojtimit u organizua testimi i pyetësorit në disa ndërmarrje nga grupi i punës i INSTAT për kuptueshmërinë e pyetjeve dhe mënyrën e plotësimit në tablet dhe transmetimit të të dhënave në INSTAT. Nga testimi rezultoi se një pjesë e menaxherëve të ndërmarrjeve të kontaktuar kërkonin krahas përdorimit të tabletave dhe një pyetësor fizik në mënyrë që një pjesë të pyetjeve të kishin mundësi t'i diskutonin dhe me punonjësit e tyre. U organizua një ditë trajnim me anketuesit e terrenit për përmbajtjen e pyetësorit, mënyrën e plotësimit, mënyrën e përdorimit të tabletit, mënyrën e komunikimit, detyrat dhe të drejtat e anketuesve, përgjegjësitë për materialet e marra. Gjithashtu, në fund të trajnimit u ushtrua test praktik për njohuritë e marra gjatë trajnimit. Trajnimi u krye nga punonjësit e INSTAT.

#### ***II.2.5. Puna në terren***

Ndërmarrjet e përzgjedhura u identifikuan sipas listës paraprake dhe adresave përkatëse dhe u intervistuan sipas rregullave të përcaktuara. Gjatë periudhës së terrenit anketuesit u kontrolluan dhe u monitoruan nga grupi i punës i INSTAT sipas një plani lëvizjeje. Grupe me nga 3 ekspertë, ku 1 ekspert ishte nga TI, monitoruan terrenin dhe ndihmuan anketuesit për transmetimin e të dhënave.

#### ***II.2.6. Përpunimi i të dhënave dhe analiza***

Veprimet që u kryen për përpunimin e të dhënave konsistojnë në editim, kodifikim, verifikim si dhe kontroll i konsistencës së pyetjeve. Aplikacioni në tablet automatizoi rrugën që ndiqet përgjatë pyetësorit, si dhe mundësoi ekzekutimin e një bashkësie kontrollesh konsistence gjatë intervistës, gjë e cila lehtësoi shumë procesin e pastrimit të të dhënave. Editimi i të dhënave përfshiu kontrollin e rangut, strukturën e pyetjeve, aktivitetin ekonomik, si dhe konsistencën e brendshme të pyetjeve. Pas pastrimit të të dhënave u krye procesi i ripeshimit dhe përgatitja e

skedarit për analizë. Faza përfundimtare përfshiu studimin e të dhënave, tabelimin e rezultateve, analizën, si dhe përgatitjen e raportit.

### II.3. Raporti Teknik

#### II.3.1 Përgjithësimi i të dhënave

Të dhënat e anketës janë përgjithësuar për të gjithë popullatën në studim (në të gjitha seksionet me 20 të punësuar e më shumë, përjashtuar seksionin O). Procesi i përgjithësimit të të dhënave merr parasysh probabilitetin e zgjedhjes së ndërmarrjeve dhe, gjithashtu, kompenson për ndërmarrjet të cilat janë:

- Pa kontakt;
- Refuzuan që të marrin pjesë në anketë;

si dhe vlerëson numrin e ndërmarrjeve të cilat dalin jashtë qëllimit të vërtetimit (të mbyllura dhe të fjetura).

Për të gjitha ndërmarrjet që janë pa kontakt dhe kanë refuzuar të përgjigjen (17.8%), pesha e tyre është kompesuar duke u shpërndarë tek ndërmarrjet e përgjigjura brenda stratës së tyre fillestare nga ku ato janë përzgjedhur, duke pasqyruar në këtë mënyrë karakteristikat e tyre brenda grupit homogjen.

Pra, pesha e *design*-it  $dk$  është korrektuar me koeficientin rregullues  $V_{kh}$ , i cili llogaritet:

$$V_{kh} = \frac{\left( n_{(i)pergjigjur} + n_{(i)refuzim} + n_{(i)pa-kontakt} \right)}{n_{(i)pergjigjur}}$$

Vlerësimet totale për të dhënat e anketës llogariten nëpërmjet formulës:

$$\hat{T}(x) = \sum_{k \in rh} d_{kh} V_{kh} x_{kh} = \sum_{k \in rh} w_{kh} x_{kh}$$

Procesi i përgjithësimit të të dhënave merret gjithashtu dhe me trajtimin e vlerave të veçanta (*outlier*). Gjatë procesit të vlerësimit, ndërmarrjeve që kanë vlera të veçanta u jepet pesha ( $w_{kh}$ ) e barabartë me 1. Më pas bëhet rillogaritja e peshave të ndërmarrjeve të tjera në shtresëzimin të cilës i përket ndërmarrja me vlerën e veçantë:

$$d_{kh}^{adj} = \frac{N_h - m_h(out)}{n_h - m_h(out)},$$

$$\text{ku : } m_h(out) = \sum_{rh} 1_{kh} \delta_{kh}, \delta_{kh} = \begin{cases} 1 \text{ nqs objekti } k \text{ eshte outlier} \\ 0 \text{ nese nuk eshte} \end{cases}$$

$$V_{kh}^{adj} = \frac{n_h - m_h(out)}{n_{rh} - m_h(out)}$$

Në këtë mënyrë vlerësimet e përfuara me të dhënat e anketës “Për njohjen dhe reagimin ndaj sistemit të pensioneve private profesionale dhe personale në Shqipëri nga ana e punëdhënësve” i referohen formulës së mëposhtme:

$$\hat{T}(x) = \sum_{k \in rh} d_{kh}^{adj} v_{kh}^{adj} x_{kh} = \sum_{k \in rh} w_{kh}^{adj} x_{kh}$$

### II.3.2. Treguesit e saktësisë së vlerësimeve

Për çdo tregues kyç në vrojtim është llogaritur varianca duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$V(\hat{T}_x) = \sum_{h=1}^H N_h^2 \left(1 - \frac{n_h}{N_h}\right) \frac{s_h^2}{n_h}$$

Ku  $V(\hat{T}_x)$  tregon variancën për totalin e variablit,  $s^2$  tregon variancën e variablit,  $N_h$  numrin gjithsej të ndërmarrjeve në shtresën h, dhe  $n_h$  numrin e ndërmarrjeve që janë përgjigjur në shtresën h, Koeficienti i variacionit llogaritet me anë të formulës:

$$CV(\hat{T}) = \frac{\sqrt{V(\hat{T})}}{\hat{T}}$$

Llogaritja e koeficienteve të variacionit për “Numër total ndërmarrjesh” dhe “Numër total të punësuar” është realizuar në *SAS-software* duke përdorur makro *CLAN*. Më poshtë jepen devijimet standarde dhe koeficientet e variacionit për këto dy variabla kryesorë të vrojtimit për gjithë popullatën në studim:

Seksion total A-S	Nr gjithsej ndërmarrjes h	Devijimi Standard	Koeficient Variacionit (%)	Nr gjithsej të punësuar	Devijimi Standard	Koeficient Variacionit (%)
	$\hat{T}(x)$	$\sqrt{V(\hat{T})}$	$CV(\hat{T})$	$\hat{T}(x)$	$\sqrt{V(\hat{T})}$	$CV(\hat{T})$
Gjithsej	2.074	14,7089	0,71	174.903	3.397,637 8	1,94